



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Vlerësimit Institucional të
Universitetit të Sporteve të Tiranës
Prill 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Z. Grant Horsburgh

Kryetar



2. Dr. Gjergj Thomai

Anëtar



3. Znj. Penny Renwick

Anëtare

PA Renwick

Datë: Prill 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	4
Gjykim i përmbledhur	6
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	10
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	13
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	17
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	20
Lista e referencave	24

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Sporteve të Tiranës është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë që ofron nivele studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë për mësues të edukimit fizik dhe specialistë sporti. Universitetit i është dhënë titulli aktual nga Këshilli i Ministrave në vitin 2010. Megjithatë, gjeneza e institucionit daton që në vitin 1948, me themelimin e Teknikumit të Fizkulturës.

Gjatë periudhës së kryerjes së vlerësimit, universiteti ndahej në tre njësi kryesore dhe nëntë departamente: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes (Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Departamenti i Mjekësisë Sportive dhe Departamenti i Sportit); Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreative (Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizmit , Departamenti i Organizim-Menaxhimit, dhe Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit); Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit (Departamenti i Kërkimit të Lëvizjes së Aplikuar, Departamenti i Kërkimit në Veprimtarinë Fizike, Shëndetin dhe Rekreative, si dhe Departamenti i Kërkimit dhe Studimit të Tregut të Punës dhe Transferimit të Teknologjive). Krahas këtyre, ekzistojnë edhe 17 njësi administrative. Universiteti ka punësuar 74 pedagogë me kohë të plotë dhe 15 me kohë të pjesshme **[RVV fq.44]**, si dhe ofron katër programe studimi të ciklit të parë, katër programe studimi të ciklit të dytë, dhe dy programe studimi të ciklit të tretë. **[Informacion për IAL-të në faqen e internetit të APAAL-it]** Në këtë universitet vazhdojnë studimet 2,172 studentë, prej të cilëve 37 ndjekin programin e Masterit të Shkencave dhe 771 janë regjistruar në programin e Masterit Profesional.

Raport i përmbledhur

Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST), që e ushtron veprimtarinë e tij në formën aktuale që nga viti 2010, është një institucion publik, godinat e të cilit ndodhen në qendër të qytetit. Gjatë kryerjes së vlerësimit, UST-ja kishte rreth 3000 studentë dhe ofronte 10 programe studimi për të tre ciklet. Universiteti ka 74 pedagogë me kohë të plotë, që japin mësim në tre njësitë e mëposhtme kryesore: në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, dhe në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit.

Raporti i Vetëvlerësimit u hartua nga një grup i ngritur nga universiteti që përbëhej nga drejtues të nivelit të lartë, anëtarë të stafit akademik dhe personelit mbështetës, si dhe një përfaqësues i studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë brenda institucionit përpara përfundimit dhe miratimit nga Rektorati dhe Senati Akademik.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve, përkatësisht në datat 24 dhe 25 prill të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë, nga personeli i institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion raporti i vetëvlerësimit dhe dosja me dokumentet mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë përpara dhe gjatë vizitës. Larmia e informacionit mbështetës të ofruar nga universiteti, i dha mundësinë grupit të njihje me strukturën, politikat dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Dokumentet përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informimit rreth programit dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe me partnerët e jashtëm. Diskutimi mbështetej në qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të kampusit kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, laboratorët, ambientet sportive dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim në zbatim e sipër. Sidoqoftë, ai dha dy rekomandime për universitetin, që duhen marrë në konsideratë për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimdhënies së studentëve. Mungesa e një strukture të ngritur për mbikëqyrjen e vetëvlerësimeve në përputhje me ligjet në fuqi identifikohet si dobësi, dhe si rrjedhojë rekomandohet që, universiteti ta kthejë në prioritet ngritjen e kësaj njësie. **[Kapitulli III Standardi I.4].** Edhe moskontraktimi i konsulentëve të jashtëm nga ana e universitetit për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale u identifikua si dobësi, dhe si rrjedhojë rekomandohet që universiteti të identifikojë konsulentët e jashtëm, që do të ndihmojnë në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale **[Kapitulli III Standardi I.4].**

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim në zbatim e sipër. Sidoqoftë, ai dha dy rekomandime për universitetin, që duhen marrë në konsideratë për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimdhënies së studentëve. Sistemi i menaxhimit të informacionit nuk mundi t'i ofronte Grupit të Vlerësimit të Jashtëm informacione ose të dhëna strategjike, gjë që identifikohet si dobësi, dhe si rrjedhojë rekomandohet që, universiteti të rishikojë menaxhimin e sistemeve të tij të informacionit, në mënyrë që të mund të ofrojë informacionet dhe të dhënat e duhura strategjike. **[Kapitulli III Standardi VII.1]** Godinat e universitetit nuk i përmbushin siç duhet kërkesat statutorë për aksesueshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara, gjë që identifikohet si dobësi, dhe si rrjedhojë rekomandohet që, universiteti të përgatisë dhe të zbatojë një plan të caktuar për t'i siguruar studentëve me aftësi të kufizuara aksesueshmëri në të gjitha ambientet e mësimdhënies dhe mësimdhënies **[Kapitulli III Standardi VII.5].** Disa salla leksioni dhe mjetet ndihmëse për

mësimdhënien janë të papërshtatshme dhe nuk i përmbushin standardet, gjë që shihet si dobësi, prandaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që, universiteti të rishikojë menaxhimin e infrastrukturës së tij të mësimdhënies, për të siguruar përshtatshmërinë e tij për ushtrimin e veprimtarive universitare **[Kapitulli III Standardi VII.5]**.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim në zbatim e sipër. Sidoqoftë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk gjeti asnjë dobësi, dhe si rrjedhojë, për universitetin nuk u dha asnjë rekomandim, që të merrej në konsideratë si një mënyrë për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim në zbatim e sipër. Sidoqoftë, ai dha një rekomandim për universitetin, që të merret në konsideratë si një mënyrë për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardit të programeve të tij, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve. Universiteti nuk ka ngritur ende plotësisht një njësi të organizuar qendrore për mbikëqyrjen e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, gjë që shihet si dobësi, dhe si rrjedhojë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që, universiteti të zhvillojë dhe të zbatojë një infrastrukturë universitare të përshtatshme për të nxitur kthimin në prioritet të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies **[Kapitulli I Standardi II.4]**.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim në zbatim e sipër. Sidoqoftë, ai dha tre rekomandime për universitetin, që të merren në konsideratë si një mënyrë për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardit të programeve të tij, si dhe për të përmirësuar më tej përvojën e mësimnxënies së studentëve. Mungesa e një politike të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara identifikohet si dobësi, dhe si rrjedhojë rekomandohet që, universiteti të përgatisë një politikë të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara **[Kapitulli I Standardi III.4]**. Këshillat Studentore nuk mbështeten financiarisht, gjë që identifikohet si dobësi, dhe si rrjedhojë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që, universiteti të sigurojë mbështetje financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor **[Kapitulli I Standardi III.7]**. Edhe mungesa e të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për punësimin e të diplomuarve identifikohet si dobësi, prandaj Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që, universiteti të përgatisë dhe zbatojë një proces për të mundësuar krijimin e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse për ndjekjen e punësimit të të gjithë të diplomuarve të tij **[Kapitulli I Standardi III.9]**.

UST-ja e ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson nivelin e angazhimit të universitetit në proces dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një strukture të ngritur për mbikëqyrjen e vetëvlerësimeve në përputhje me ligjet në fuqi (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- moskontraktimin e konsulentëve të jashtëm nga universiteti për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**)

- sistemi i menaxhimit të informacionit nuk mundi t'i ofronte Grupit të Vlerësimit të Jashtëm informacione dhe të dhëna strategjike (pika 2.5; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- godinat e universitetit nuk i përmbushin siç duhet kërkesat statutores për aksesueshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**)
- disa salla leksioni dhe mjetet ndihmëse për mësimdhënien janë të papërshtatshme dhe nuk i përmbushin standardet (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**)
- disponueshmërinë e teksteve të shtypura në bibliotekën qendrore të universitetit (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**)
- universiteti nuk ka ngritur plotësisht një njësi të organizuar qendrore për mbikëqyrjen e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies (pika 4.3; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- mungesën e një politike të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- mungesën e mbështetjes financiare të Këshillave Studentore (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- mungesën e bazës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për punësimin e të diplomuarve (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- kthimi në prioritet i ngritjes së një njësie për mbikëqyrjen e vetëvlerësimit të veprimtarive të tij (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- identifikimi i konsulentëve të jashtëm për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- rishikimi i menaxhimit të sistemeve të tij të informacionit për të siguruar ofrimin e informacioneve dhe të dhënave të duhura strategjike (pika 2.5; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- përgatitja dhe zbatimi i një plani të caktuar për t'iu siguruar studentëve me aftësi të kufizuara aksesueshmëri në ambientet e mësimdhënies dhe mësimdhënies (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**)
- rishikimi i menaxhimit të infrastrukturës së tij të mësimdhënies për të siguruar përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarive universitare (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**)
- zhvillimi dhe zbatimi i infrastrukturës universitare të përshtatshme për nxitjen e kthimit në prioritet të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 4.3; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- përgatitja e një politike të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- sigurimi i mbështetjes financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- zhvillimi dhe zbatimi i një procesi për të mundësuar ngritjen e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse për ndjekjen e punësimit të të gjithë të diplomuarve të tij (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Sporteve të Tiranës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përbushur kryesisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Qeverisja e UST-së dhe kuadrot e tij rregullatore janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar për institucionet e arsimit të lartë. [RVV fq.6] Statuti përcakton misionin e universitetit dhe strukturat e brendshme organizative dhe drejtuese [3], ndërsa rregulloret përcaktojnë përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit. [2] Universiteti i amendon dhe ndryshon Statutin dhe rregulloret e tij sipas kërkesës. [4; 8] Senati Akademik ka ngritur një grup pune për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e Statutit dhe rregulloreve, duke pasur parasysh ligjin e ri për arsimin e lartë. [146; AE44; M3][Kapitulli III Standardi I.1]

1.2 Universiteti është organizuar në mënyrë të tillë që të sigurojë efikasitetin e drejtimit në përputhje me kërkesat e Ministrisë. [RVV fq.6-8; 2;3] Qarkullimi i informacionit nga departamentet në Senat, si dhe komunikimi i vendimeve të Senatit personelit dhe studentëve janë efikase. [RVV fq.6-10; AE43; AE44; M2; M3; M4; M5;M9;M10] Marrëveshjet për drejtimin dhe administrimin e universitetit, si dhe për vendimmarrjen kolegjiale, marrin parasysh kërkesat ligjore, funksionojnë si duhet dhe kuptohen nga i gjithë personeli në të gjitha nivelet. [RVV fq.6-10; M2; M3; M4; M9; M10][Kapitulli III Standardi I.2]

1.3 Bordet dhe këshillat e universitetit mblidhen rregullisht dhe informacioni për pikat e axhendës i vihet paraprakisht në dispozicion të gjithë personelit në mënyrë elektronike. [RVV fq.8; AE43; AE44; M2; M3; M4; M9; M10] Studentët dhe personeli treguan se çështjeve të ngritura prej tyre iu dha rëndësia e duhur nga bordet dhe këshillat nëpërmjet debatit konstruktiv. Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, si dhe për mbështetjen e diskutimeve dhe debatit kolegjial janë kuptuar nga personeli dhe studentët.[M2; M3; M4; M5; M9; M10] Dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve iu ngarkohet detyra e monitorimit në shkallë vendore të zbatimit të vendimeve të bordeve dhe këshillave të universitetit. [M2; M3; M4; M9; M10][Kapitulli III Standardi I.3, Kapitulli III Standardi II.3]

1.4 UST-ja sigurohet që të respektohen kufijtë e autonomisë së saj dhe që ta ushtrojë veprimtarinë e saj brenda kufijve të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi. [RVV fq.8-9] Vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë shkencore dhe të mësimdhënies, si dhe në çështjet financiare dhe administrative. [AE43; AE44; M2; M3; M4; M9; M10] Gjatë kryerjes së vlerësimit të jashtëm, universiteti po ngrinte Zyrën e Standardeve dhe Kurrikulës për të mbikëqyrur efikasitetin e veprimtarive të vetëvlerësimit. [M2; M4; M9; M10] Sidoqoftë, grupi e konsideroi mungesën e strukturës së ngritur për mbikëqyrjen e vetëvlerësimit në përputhje me ligjet në fuqi si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti ta kthejë në prioritet ngritjen e një njësie për mbikëqyrjen e vetëvlerësimit dhe veprimtarive të tij. Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Teknologjisë së Informacionit është përgjegjëse për t'u siguruar se universiteti përfiton nga mundësitë për financime evropiane. [RVV fq.8-9; 27; M4; M9] Sidoqoftë, universiteti nuk ka kontraktuar konsulentë të jashtëm për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale, gjë që grupi e konsideroi si **dobësi**. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të identifikojë konsulentët e jashtëm për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale. [Kapitulli III Standardi I.4]

1.5 Universiteti ka një strategji zhvillimi të përshtatshme për periudhën 2016-2020, që është miratuar nga Senati. [RVV fq.9; 18; AE33] Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e universitetit, dhe u mor në konsideratë gjatë fazave të ndryshme të përgatitjes së saj nga bordet dhe këshillat drejtues. [RVV fq.9-10; M3;M4; M9][Kapitulli III

Standardi I.5]

1.6 Raporti vjetor i Ministrisë ofron shpjegime për programet e mësimdhënies dhe studimit, kërkimin shkencor, personelin, veprimtarinë e projektit dhe çështjet ekonomike dhe financiare. **[34; FE30 (në gjuhën shqipe)]** Procesi i hartimit është bazuar mbi raportet e vlerësimit të brendshëm dhe vetëvlerësimit për veprimtaritë e departamentit dhe programit të studimit. Raporti përfundimtar është vënë në dispozicion të bordeve dhe komisioneve përkatëse të universitetit, si dhe iu ofrohet personelit dhe studentëve falas nëpërmjet faqes së universitetit. **[RVV fq.10; M2; M3; M4; M9; M10][Kapitulli III Standardi I.6]**

1.7 Fakultetet dhe departamentet janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore. Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Stafi akademik është i kualifikuar sipas kërkesave dhe ushtron autonomi dhe liri akademike gjatë mësimdhënies, kërkimit dhe të gjitha veprimtarive të tjera akademike. Universiteti ka faqen e tij zyrtare të internetit dhe ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. **[RVV fq.10; informacion për IAL-të në faqen e APAAL-it; M2; M3; M4; M9; M10][Kapitulli III Standardi II.1]**

1.8 Universiteti ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshin institucionet e arsimit të lartë dhe organet publike. **[RVV fq.11-12; AE34; AE46]** Stafi akademik, alumnit dhe ofruesit e vendeve të praktikës treguan se ka lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe rajonale, dhe departamenteve dhe programeve. Kjo gjë, dhe kërkimi i tregut i kryer në nivel institucional, mundësojnë informimin e duhur të fakulteteve, departamenteve dhe programeve për mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal. **[RVV fq.11; AE46; M3; M4; M6; M9; M10]** Sapo të nisë të funksionojë plotësisht, Zyra e Standardeve dhe Kurrikulës do të marrë përsipër përgjegjësinë për monitorimin e punësimit të të diplomuarve. Shihni edhe pikën 5.9. **[RVV fq.11; M2; M3; M4; M9; M10][Kapitulli III Standardi III.1, Kapitulli III, Standardi III.2]**

1.9 Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Teknologjisë së Informacionit mbikëqyr zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët e huaj, ndërsa departamentet kujdesen për mbikëqyrjen e bashkëpunimeve vendore dhe rajonale. **[RVV fq.11-12; AE34; AE46; M4]** Po ashtu, bashkëpunimi me organizatat e tjera për t'i ofruar studentëve mundësitë për kryerjen e praktikës profesionale, administrohet në nivel departamenti. **[Kapitulli III, Standardi III.3]**

1.10 UST-ja ka lidhur një sërë marrëveshjesh formale që iu mundësojnë personelit dhe studentëve pjesëmarrjen në veprimtaritë ndërkombëtare të organizuara në Austri, Danimarkë, Greqi dhe Itali. **[RVV fq.12-13; 27;28]** Universiteti ka hartuar dhe zbatuar politika për të mbështetur mobilitetin ndërkombëtar të stafit akademik dhe studentëve. **[RVV fq.13; M2; M3; M4; M5]** Sidoqoftë, drejtuesit e lartë e shikojnë ofrimin e mundësive të pakta për mobilitet ndërkombëtar për personelin dhe studentët si sfidë të vazhdueshme dhe si një fushë që do të zhvillohet në të ardhmen. **[M2; M3; M4; M5][Kapitulli III Standardi III.4]**

1.11 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një strukture të ngritur për mbikëqyrjen e vetëvlerësimeve në përputhje me ligjet në fuqi (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- moskontraktimin e konsulentëve të jashtëm nga universiteti për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- kthimi në prioritet të ngritjes së një njësie për mbikëqyrjen e vetëvlerësimit të veprimtarive të universitetit (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**)
- identifikimi i konsulentëve të jashtëm për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e veprimtarive institucionale (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Universiteti ka një strukturë të qartë që përcakton përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve në përputhje me kërkesat statutorë. **[RVV fq.14-15; 2; 3; AE2]** Punësimi i personelit të universitetit rregullohet si nga statutet e jashtme, ashtu edhe nga rregulloret e vetë universitetit. Universiteti, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, të Burimeve Njerëzore dhe Arkivit, i shpall vendet e lira në Agjencinë e Prokurimit Publik të Universitetit dhe faqen e tij të internetit. Kriteret e punësimit vihen në dispozicion të palëve të interesit nëpërmjet faqes së internetit të universitetit, ndërsa procedura e punësimit është e njëjtë si për stafin akademik, ashtu edhe për personelin administrativ. **[AE54][Kapitulli III Standardi IV.1, Kapitulli III Standardi II.2]**

2.2 Universiteti ka krijuar një ndjenjë të fortë komuniteti dhe integrimi te personeli dhe studentët e tij. **[RVV fq.15-16; AE3]** Personeli dhe studentët pohuan se pjesëmarrja nëpër veprimtari të përbashkëta të organizuara në nivel qendror si p.sh në panairë pune, veprimtari sociale apo konkurse sportive, i kanë ndihmuar ata që të integrohen plotësisht në komunitetin e universitetit. **[M1; M2; M3; M4; M5; M6][Kapitulli III Standardi IV.2, Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.3 UST-ja ka procedura të përshtatshme për efikasitetin e stafit të tij akademik. **[RVV fq.16; AE4-7; M2; M3; M4; M5; M10]** Procesi i vlerësimit bazohet në ndërthurjen e vlerësimit të zhvillimit të mësimdhënies përgjatë vitit akademik nga menaxherët e linjës së pedagogëve dhe analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Rritja profesionale e planifikuar e personelit bazohet në prioritetet e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit, dhe përfshin nxitjen e personelit për të kërkuar kualifikime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, veçanërisht në nivelet Master dhe Doktoraturë. **[RVV fq.16; AE33; M1; M2; M3; M4; M10]** Universiteti fton akademikët ndërkombëtarë me kualifikimet e duhura që të marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes dhe ngritjes në detyrë. Për marrjen e titullit “Profesor” është parakusht që pedagogët të kenë minimumi një përvojë njëvjeçare në mësimdhënie në një universitet perëndimor. **[RVV fq.16; AE4-7; AE54; M2; M3; M4; M5; M10][Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.4 Universiteti ka procedura transparente për menaxhimin e burimeve financiare. Procedurat janë në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar publik, dhe për këtë çështje, hartohen raporte, që i dërgohen Ministrisë. Buxhetet janë të centralizuara dhe kërkesat e departamenteve dhe fakulteteve shqyrtohen nga Rektori përpara se të rishikohen nga Bordi i Administrimit, dhe më pas të miratohen nga Senati. Përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm, administrimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit janë Rektori dhe Kancelari, të mbështetur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, ku menaxhimi i përditshëm i transferohet fakulteteve për të mbështetur zbatimin e prioritetëve të identifikuar. **[RVV fq.17-19; 2; AE9-12 (në gjuhën shqipe); M3; M4; M9]** Për të qenë në përputhje me kërkesat rregullatore dhe ligjore, UST-ja i nënshtrohet një sërë procesesh auditimi të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë auditimin nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga Ministria. **[RVV fq.19; M3; M4; M9][Kapitulli III Standardi VI.2, Kapitulli III Standardi VI.3, Kapitulli III Standardi VI.1]**

2.5 UST-ja ka një sistem të integruar informacioni të mbështetur në Politikën e Komunikimit. **[RVV fq.19; AE14 (në gjuhën shqipe)]** Sistemi menaxhon informacionin për studentët, që përfshin procesin e pranimeve, materialet e mësimdhënies dhe mësimdhënies, planet mësimore, informacionin për vlerësimin dhe informacione të tjera përkatëse gjatë kohës së tyre në universitet. Gjithashtu, sistemet e emaileve të studentëve dhe personelit janë integruar plotësisht me sistemin. **[RVV fq.19; M3; M4; M5; M9; M10]** Sidoqoftë, përpara dhe gjatë vizitës, sistemi nuk mundi t'i ofronte Grupit të Vlerësimit të Jashtëm informacione ose të dhëna strategjike, gjë që grupi e ka cilësuar si **dobësi**. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të rishikojë menaxhimin e

sistemeve të tij të informacionit, për të siguruar ofrimin e informacioneve dhe të dhënave të duhura strategjike. Universiteti ka përfunduar së fundmi rishikimin e faqes së tij të universitetit, që tashmë ofron informacion në gjuhën shqipe dhe angleze. **[Faqja e internetit e universitetit; M5; M7; M8] [Kapitulli III Standardi VII.1]**

2.6 Universiteti ka infrastrukturë të përshtatshme të teknologjisë së informacionit që përmbush nevojat e personelit dhe studentëve. Interneti dhe Wi-Fi janë të disponueshme kudo në mjediset e universitetit. Laboratorët e praktikës janë të larmishëm dhe janë të pajisur me mjete të specializuara për mbështetjen e të nxënësve të studentëve, si dhe numri i njësive të kompjuterëve nëpër auditorë është i përshtatshëm për përmbushjen e nevojave të mësimnxënies së studentëve. Në kohën e kryerjes së vlerësimit të jashtëm, universiteti nuk ofronte programe të të nxënësve në distancë. **[RVV fq.19-20; AE16-18 (në gjuhën shqipe); turi për burimet e të nxënësve; M5; M9; M10] [Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.7 UST-ja ka miratuar Politikën e Menaxhimit të Pasurive, që përcakton qartësisht rolet dhe përgjegjësitë e menaxhimit në lidhje me pasuritë e paluajtshme të universitetit. **[RVV fq.20-23; AE19 (në gjuhën shqipe)]** Universiteti po planifikon të përmirësojë mjediset sportive dhe auditorët aktualë, ku do të përfshihet edhe përmirësimi i ambienteve për studentët me aftësi të kufizuara në lëvizje. **[M1; M2; M3; M4; M5; M9; turi për burimet e të nxënësve]** Sidoqoftë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron faktin se godinat e universitetit nuk i përmbushin siç duhet kërkesat statutorë për aksesueshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara si **dobësi**. Ai **rekomandon** që universiteti të përgatisë dhe të zbatojë një plan të caktuar për t'i ofruar studentëve me aftësi të kufizuara aksesueshmëri në të gjitha mjediset e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Po ashtu, standardi i disa sallave të leksioneve, dhe mjetet ndihmëse për mësimdhënie, janë të papërshtatshme dhe nuk i përmbushin standardet, gjë që u identifikua nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të rishikojë menaxhimin e infrastrukturës së tij të mësimdhënies, për të siguruar përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarive universitare. **[Kapitulli III Standardi VII.3, Kapitulli III Standardi VII.5, Kapitulli III Standardi V.1]**

2.8 Universiteti ka një politikë të përshtatshme për të siguruar ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kulturës dhe trashëgimisë së tij akademike dhe shkencore. **[RVV fq.22]** UST-ja e siguron zhvillimin e kulturës së tij duke ruajtur syllabuset dhe literaturën përkatëse për të gjitha programet e studimit, si dhe botimet dhe tekstet shkollorë të hartuara nga personeli akademik me kohë të plotë në bibliotekë, në përputhje me legjislacionin shqiptar. **[RVV fq.24; AE20 (në gjuhën shqipe); M2; M3; M9; turi për burimet e të nxënësve] [Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.9 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit është hartuar për të siguruar vijimësinë e ofrimit të një kurrikule bashkëkohore të orientuar drejt tregut përmes programeve të tij. **[RVV fq.21-22; AE21 (në gjuhën shqipe)]** Personeli i fakultetit mbështetet të punojë me projekte të financuara nga jashtë për të promovuar veprimtaritë kërkimore dhe mësimdhënëse të universitetit. Ambientet sportive universitare iu vihen në dispozicion komunitetit vendas, si dhe federatave dhe klubeve sportive, në përputhje me kërkesat ligjore. Rektorati është përgjegjës për vlerësimin e ofrimit të shërbimeve të tilla, për të siguruar kryerjen e të gjitha veprimtarive universitare me efikasitet. **[M2; M3; M4; M5; M6; M7; M8; turi për burimet e të nxënësve] [Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.10 Universiteti i regjistron dhe i ruan të gjitha dokumentet zyrtare në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV fq.23-24; AE56 (në gjuhën shqipe)]** Rektorati, Drejtoria Juridike, e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit, si dhe Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve mbajnë përgjegjësi individuale për ruajtjen e dokumentacionit përkatës në version të shtypur dhe elektronik. **[RVV fq.23-24; M4; M9][Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- sistemi i menaxhimit të informacionit nuk mundi t'i ofronte Grupit të Vlerësimit të Jashtëm informacione dhe të dhëna strategjike (pika 2.5; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- godinat e universitetit nuk i përmbushin siç duhet kërkesat statutorë për aksesueshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**)
- standardi i disa sallave të leksioneve dhe mjetet ndihmëse për mësimdhënien janë të papërshtatshme dhe nuk i përmbushin standardet (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- rishikimi i menaxhimit të sistemeve të tij të informacionit për të siguruar ofrimin e informacioneve dhe të dhënave të duhura strategjike (pika 2.5; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- përgatitja dhe zbatimi i një plani të caktuar për t'iu ofruar studentëve me aftësi të kufizuara aksesueshmëri në ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**)
- rishikimi i menaxhimit të infrastrukturës së tij të mësimdhënies për të siguruar përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarive universitare (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.5**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, universiteti ofron programe specializimi për mësuesit, trajnuesit, specialistët dhe kërkuesit në fushën e edukimit fizik dhe të sportit. Në këtë mënyrë, universiteti synon të arrijë standardet akademike bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare më të larta, si edhe të mbështesë arrijtjet arsimore në kërkimin sportiv. **[RVV fq.26; 2; 6; M1]** Për të marrë informacionin e nevojshëm për hartimin e objektivave të programit, UST-ja mban kontakte me Drejtoritë Arsimore Rajonale, shkollat e mesme të përgjithshme dhe sportet profesionale, si dhe prodhon një sërë fletëpalosjesh informuese për programin. **[RVV fq.26; 42; 43; 44; 45; M1]** Në kohën e kryerjes së vlerësimit të jashtëm, në programet e universitetit ishin regjistruar 12 studentë në shkallë ndërkombëtare nga vende shqipfolëse. **[RVV fq.27; FE14; M3]** UST-ja, në përputhje me rregulloret e saj, ofron programe studimi individuale për atletët elitë. **[5] [Kapitulli I Standardi I.1]**

3.2 UST-ja është ndarë në dy fakultete të mësimdhënies dhe në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit. Programet ofrohen me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në nivel universitar dhe me kohë të plotë në nivel pasuniversitar. **[2; M1]** Universiteti ndjek një politikë për rritjen e diversitetit të studentëve të rinj, duke përfshirë edhe rritjen e përqindjes së studenteve dhe studentëve nga e gjithë Shqipëria. Vëmendje e veçantë i është kushtuar tërheqjes së studentëve nga rajoni, veçanërisht nga territore si Kosova, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Maqedonia. **[RVV fq.26; AE54; M3]** Për shkak të ligjit të ri për arsimin e lartë, UST-ja është në pritje të miratimit për rifillimin e rekrutimit të doktorantëve. **[M1]** UST-ja po merr në konsideratë përgatitjen e programeve si p.sh ato për trajnuesit personalë dhe punëdhënësit, të cilët do ta mirëprisnin një zhvillim të tillë. **[M1; M6] [Kapitulli I Standardi I.2]**

3.3 Programet e UST-së përputhen me secilën prej tre cikleve të Procesit të Bolonjës. **[RVV fq.29; 5; M1]** Universiteti e ushtron veprimtarinë e tij brenda kontekstit të Planit të tij Strategjik 2016-2020, ku identifikohet në mënyrë të veçantë zhvillimi i programeve të Masterit Profesional. **[23]** Në suplementet e lëshuara të diplomës, përcaktohen edhe modulet e studiuara. **[80] [Kapitulli I Standardi I.3]**

3.4 Programet e studimit janë në përputhje me prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. UST-ja mban kontakte të ngushta me Ministrinë, partnerët ndërkombëtarë, si dhe me shkollat. **[AE46; M1; M6]**. Plani Strategjik 2016-2020 është hartuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet zhvillimeve ekonomike dhe sociale të vendit, në interes të studentëve dhe punëdhënësve. **[23]** Në misionin e universitetit përfshihet një qëllim specifik për pjesëmarrje nëpër bashkëpunime ndërkombëtare dhe disa objektiva për nxitjen e bashkëpunimit me organizatat e sportit në Shqipëri. **[23; AE46; AE63; M1][Kapitulli I Standardi I.4]**

3.5 Universiteti ofron katër programe Bachelor (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme), katër programe Masteri me kohë të plotë, dhe dy programe Doktorature, si dhe ka 2,980 studentë gjithsej. Personeli punon sipas ngarkesës mësimore të përcaktuar nga Ministria. **[76]** Universiteti ka 79 pedagogë me kohë të plotë dhe 43 me kohë të pjesshme, prej të cilëve 18 kanë doktoraturë. **[2; FE18]** Në ofrimin e mësimdhënies së ciklit të parë dhe të dytë, 70 për qind e personelit akademik punojnë me kohë të plotë. **[32; 87]** I gjithë personeli pritet të angazhohet në kërkim. Sipas të dhënave të një fakulteti, personeli ia kushton 70 për qind të kohës së tyre mësimdhënies, ndërsa 30 për qind kërkimit. Për sa i përket personelit në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit, raporti është i kundërt. **[M1; M3; M7][Kapitulli I Standardi I.5]**

3.6 Senati bën mbikëqyrjen e programeve arsimore. **[5]** Objektivat arsimore janë përcaktuar qartësisht në programet dhe modulet e miratuara për secilin cikël studimor. **[RVV fq.29; AE65; FE1-8]** Specifikimet e modulit përcaktojnë objektivat e mësimnxënies

dhe metodat e vlerësimit. **[69; FE1-8]** Gjatë vlerësimit të jashtëm, personeli dha versione të ndryshme për kohën që i kushtohet teorisë dhe praktikës për cikle të ndryshme studimi, që përfshinin ndarjen e barabartë të kohës midis teorisë dhe praktikës, ndarjen e kohës ndërmjet teorisë dhe praktikës në shkallën 60 për qind teori dhe 40 për qind praktikë, si dhe në shkallën 40 për qind teori dhe 60 për qind praktikë. **[M1; M3; M8]** Specifikimet e modulit **[FE1-8]** tregojnë se koha kushtuar praktikës nuk është gjithmonë e mirëpërcaktuar, dhe se ka mungesë të raportimit kryesisht për programet e Masterit të Shkencës. **[FE4; FE8]** Kriteret e pranimit të studentëve janë përcaktuar qartësisht nga çdo fakultet. **[RVV fq.29; FE10-12][Kapitulli I Standardi I.6]**

3.7 Kurrikulat e ciklit të parë iu ofrojnë studentëve njohuritë bazë dhe shkencën themelore të edukimit fizik, sportit dhe shëndetit. **[RVV fq.29; 50; 54; FE1, 2, 5 & 6]** Kurrikulat janë strukturuar në mënyrë të tillë që të lejojnë zgjerimin e njohurive shkencore lidhur me disiplinën. **[RVV fq.34; 50]** Rregulloret përcaktojnë kriteret të qarta për ofrimin e programit të ciklit të parë, dhe për kalimin në rang ngjithës në programet e ciklit të dytë dhe të tretë. **[RVV fq.29; 5]** Rregulloret përmbajnë dispozita për transferimin e studentëve brenda ose jashtë universitetit. **[RVV fq.29; 5]** Të diplomuarit pajisen me një suplement diplome, që tregon qartësisht se të diplomuarit janë të aftë për punësim. **[80; AE65]** Në përputhje me kërkesat ligjore, të diplomuarit në Bachelor janë të përshtatshëm për të punuar në qendra fitnesi ose si ciceronë, por jo në arsimin e lartë. Gjithashtu, universiteti kërkon në mënyrë aktive që të mbajë të diplomuarit më të mirë. **[RVV fq.30; M4][Kapitulli I Standardi I.7]**

3.8 Plani strategjik përcakton qartësisht synimin për t'iu ofruar studentëve mbështetjen që ata kanë nevojë përgjatë studimeve të tyre. **[23]** Hartuesit e modulit dhe pedagogët informojnë studentët e vitit të parë rreth objektivave të mësimnxënies. **[RVV fq.30; M5]** Në rregullore, përcaktohet qartësisht procesi për rekrutimin e stafit akademik, ndërsa në planin strategjik shprehet qartësisht qëllimi për përmirësimin e kapaciteteve shkencore dhe veprimtarinë e personelit. Të gjithë stafit akademik i vihet në dispozicion koha e nevojshme për të bërë kërkime. **[5; 23; M1; M3][Kapitulli I Standardi I.8]**

3.9 I gjithë stafi akademik ndërmerr kërkime, dhe gjatë kryerjes së vlerësimit të jashtëm, anëtarët e tij pohuan se koha e tyre menaxhohet me efikasitet. **[M3; M8]** Ofrimi i Masterit është tregues i një përshtatjeje strategjike me politikat e kërkimit shkencor të universitetit. **[RVV fq.31; 23; 78; 89]** Praktika profesionale është pjesë përbërëse e programeve dhe kryhet në bashkëpunim me organizatat e punëdhënësve vendorë. Për shembull, Drejtoria Arsimore Rajonale bashkëpunon me Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, ndërsa lidhja e marrëveshjes formale me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit mbështet bashkëpunimin me Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit. **[RVV fq.31;5; 33; 34; AE61; FE23 & 25]** Çdo kosto për mësimdhënien shtesë mbulohet nga universiteti. **[FE9][Kapitulli I Standardi I.9]**

3.10 Kurrikulat janë organizuar në module dhe kredite të caktuara sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, ndërsa zhvillimi i mëtejshëm i tyre mbështetet përmes bashkëpunimit me BE-në. **[RVV fq.32; 84; 86; 93]** Stafit akademik i kërkohet të tregojë kompetenca gjuhësore për aplikimin, ndërsa të nxënit e gjuhës është kthyer në pjesë përbërëse të programeve. **[5; 93]** Si pjesë e politikës së ndërkombëtarizimit, studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë i nënshtrohen provimit të gjuhës së huaj, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. **[94; AE66]** Të diplomuarve të programeve të ciklit të parë dhe të dytë iu jepet diploma së bashku me suplementin e saj në gjuhën angleze dhe shqipe. **[RVV fq.32; 79; 80]** Universiteti iu ofron studentëve informacion për mundësitë e transferimit të krediteve dhe programeve, si dhe siguron transferimin e krediteve për studentët që vijnë nga universitete të tjera, vendase ose të huaja. Rregulloret e universitetit parashikojnë edhe transferimet brenda dhe jashtë institucionit. **[5; 83; 84][Kapitulli I Standardi I.10]**

3.11 Programet e studimit janë organizuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë vënien e teorisë në praktikë. Kjo gjë realizohet përmes një larmie mundësish, ku përfshihen orët e ushtrimeve, orët e laboratorit, orët e praktikës në palestra, si dhe projektet jashtë në terren, duke vendosur kështu ekuilibrin e duhur ndërmjet teorisë dhe praktikës. Studentët duhet të ndjekin 75 për qind të orëve praktike përpara se të vlerësohen. Të gjitha programet përfshijnë prezantimin e tezës. **[RVV fq.33; 5; 93; M3; M6; M8]** Personelit dhe studentëve iu ofrohet mundësia e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare. **[RVV fq.33; 46; 47; M3; M7; M8]** **[Kapitulli I Standardi I.11]**

3.12 Programet i pajisin studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme praktike për kurrikulat e edukimit fizik nëpër shkolla, ndërsa të diplomuarit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë ciceronë ose instruktorë fitnesi. **[RVV fq.3; 95; 96; FE23 & 25; M4]** Përmbajtja e kurrikulës është e përshtatshme në aspektin profesional, bazohet në kërkimin e tregut të punës, si dhe programet janë strukturuar në mënyrë të tillë që të përfshijnë elemente teorike dhe praktike. **[RVV fq.33; 5; 84; 93; M1; M3; M4; M8]** Studentët janë shumë të kënaqur me zhvillimin profesional dhe me përgatitjen e tyre për punësim. **[Anketimi i Studentëve]** **[Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Universiteti ka procese të përshtatshme për të siguruar organizimin dhe dokumentimin efikas të programeve të studimit. [RVV fq.35; 89; 90; M3; M9; M10] UST-ja ka lidhur marrëveshje me institucionet vendore publike dhe private, në mënyrë që studentët të mund të realizojnë praktikën dhe veprimtaritë praktike. [RVV fq.35; 86; 91; 92; M3; M8, M9; M10] Vihet re se të gjitha veprimtaritë praktike dhe laboratorike mbikëqyren në nivelin e duhur. [turi për burimet e të nxënit; M6] Literatura mbështetëse mbahet në bibliotekën qendrore të universitetit dhe departamentet janë përgjegjëse për t'iu garantuar studentëve akses në materialet e duhura mbështetëse. Pavarësisht pohimit të studentëve se janë të kënaqur me disponueshmërinë e literaturës mbështetëse, kryesisht nëpërmjet internetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi disponueshmërinë e teksteve të shtypura në bibliotekën qendrore të universitetit si **dobësi** [95; 96; turi për burimet e të nxënit; M5; M10][Kapitulli I Standardi II.1]

4.2 Rregullat për provimet në UST janë përcaktuar në Statut dhe rregullore. [RVV fq.36; 2; 3; M2; M3; M4; M10] Studentët pohuan se ata i njohin proceset e vlerësimit dhe ankimit të notave, dhe se nuk kanë shqetësime lidhur me konfidencialitetin në procesin e vlerësimit. [M5][Kapitulli I Standardi II.2]

4.3 Universiteti përdor një proces të përshtatshëm për sigurimin e përmirësimit e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Procesi përfshin anketimet e studentëve dhe personelit, si dhe monitorimin e programit vjetor. [RVV fq.36-37; 110-114; FE26; M2; M3; M4; M5; M9; M10] Në fund të çdo viti akademik, departamentet rishikojnë programet e tyre dhe identifikojnë fushat për përmirësim të mëtejshëm, duke përfshirë listat e materialeve për lexim të çdo moduli të kursit. Procesi i vetëvlerësimit të departamentit kryhet nga stafi akademik i departamentit. [RVV fq.37; AE5; FE30; M2; M3; M4; M5; M9; M10] Megjithatë ekzistojnë strukturat mbështetëse për nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në fakultete, universiteti nuk ka ngritur plotësisht një njësi të organizuar qendrore për mbikëqyrjen e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi këtë gjë si **dobësi**, dhe si rrjedhojë **rekomandon** që universiteti të zhvillojë dhe zbatojë infrastrukturën e përshtatshme universitare për të nxitur kthimin në prioritet të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. [Kapitulli I Standardi II.3, Kapitulli I Standardi II.4]

4.4 Departamentet janë njësitë themelore të universitetit, dhe si të tilla luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen e veprimtarisë kërkimore të personelit të tyre. [RVV fq.37-42; 2; 3; M2; M3; M4; M9; M10] Departamentet caktojnë jo vetëm prioritetet e kërkimit, por edhe mënyrën e tyre të financimit, në konsultim me institutet e kërkimit të krijuara rishtazi. Gjithashtu, universiteti ka përfituar në mënyrë aktive financim përmes bursave të ofruara nga programet Tempus dhe Erasmus+. Për të mbështetur më tej këtë fushë zhvillimi, universiteti po nxit angazhimin dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. [104-108; M10] Çdo departament harton një raport vjetor për Senatin, ku vlerësohet kryerja e veprimtarive kërkimore. [AE5 (në gjuhën shqipe); AE43; AE44; FE30 (në gjuhën shqipe)] Anëtarëve të stafit iu caktohet koha për kërkim në ngarkesën e tyre vjetore, ndërsa personeli dhe studentët mbështeten nga universiteti për të marrë pjesë në konferenca. [AE5 (në gjuhën shqipe); AE43; AE44; FE20] Pedagogëve iu kërkohet çdo vit të prezantojnë punën e tyre në të paktën një konferencë shkencore të brendshme, ose të botojnë një artikull shkencor në një revistë. [AE14; AE27; AE42 (të gjitha në gjuhën shqipe); M4][Kapitulli II Standardi I.1, Kapitulli II Standardi I.2, Kapitulli II Standardi I.3, Kapitulli II Standardi I.4, Kapitulli II Standardi I.6]

4.5 Universiteti po përpiqet të rekrutojë staf akademik me kualifikimet dhe përvojën e duhur, si dhe të mbështesë dhe nxisë pjesëmarrjen e studentëve në kërkim. Për të nxitur më tej bazën e kërkimit dhe politikën e ndërkombëtarizimit, universiteti po përpiqet të integrojë ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor nëpërmjet marrëveshjeve me partnerë të ndryshëm, si dhe të integrojë kërkuesit e huaj dhe të nxisë mobilitetin e stafit akademik. **[RVV fq.40;103; AE4;M4; M10][Kapitulli II Standardi I.5]**

4.6 Universiteti mbështet departamentet në organizimin e seminareve dhe simpoziumeve. UST-ja i publikon rezultatet e veprimtarisë kërkimore në Revistën e Veprimtarive Fizike dhe Sportit dhe në faqen e saj të internetit. Gjithashtu, universiteti ka një sistem informacioni online për veprimtaritë kërkimore dhe botimet e stafit, si dhe të gjitha departamentet publikojnë një listë të veprimtarive të tyre shkencore dhe të botimeve të përvitshme. **[RVV fq.41; 116; AE5 (në gjuhën shqipe); faqja e internetit e universitetit; M4; M10][Kapitulli II Standardi I.7, Kapitulli II Standardi I.8]**

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- disponueshmërinë e teksteve të shtypura në bibliotekën qendrore të universitetit (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**)
- ngritja jo e plotë e një njësie të organizuar qendrore për mbikëqyrjen e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies (pika 4.3; **Kapitulli I Standardi II.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- zhvillimi dhe zbatimi i infrastrukturës së përshtatshme universitare për nxitjen e kthimit në prioritet të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 4.3; **Kapitulli I Standardi II.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Në Planin Strategjik 2016-2020 shprehet qartë angazhimi për të mbështetur dhe ndihmuar studentët e të gjitha cikleve me informacione dhe orientime. **[23]**. Senati miraton kriteret e pranimit dhe monitoron zbatimin, ndërsa Zëvendës Rektori mbikëqyr procesin. **[5; FE10; FE11; FE12; FE14; M3]** Universiteti ka rishikuar provimet e tij hyrëse dhe ka ndryshuar raportin teori-praktikë gjatë përcaktimit të treguesve gjithëpërfshirës të aftësive lëvizëse dhe sportive të aplikantëve, me qëllim rritjen e numrit të studenteve të pranuar. **[RVV fq.42; 32; 125-128; FE10; FE11; FE12; M3]** Për vitin akademik 2016-2017, numri i vajzave dhe djemve të rekrutuar nga UST-ja është i barabartë. **[Të dhëna institucionale; M3; M4] [Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 Njësia e Kurrikulës dhe Standardeve mbështet pranimin e studentëve të rinj. Universiteti ka një faqe interneti gjithëpërfshirëse dhe prodhon një larmi fletëpalosjesh pranimi, duke përfshirë edhe disa në gjuhën angleze. **[42-45; 70; faqja e internetit e universitetit]** Fakultetet mbajnë kontakte me Zyrën Arsimore Rajonale, shkollat e mesme dhe shkollat profesionale sportive, si edhe marrin pjesë në aktivitete të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[RVV fq.43; AE57; AE58; AE61; M4]** Në Anketimin e Studentëve, studentët raportojnë virtualisht se ata janë të kënaqur me atë çka UST-ja reklamon ose premtion përpara fillimit të studimeve, dhe të gjithë studentët që u takuan gjatë vlerësimit të jashtëm u shprehën pozitivisht për përvojën e tyre të aplikimit. **[Anketimi i Studentëve; M5]** Për të mbrojtur cilësinë e përvojës së mësimnxënies, janë monitoruar me kujdes raportet pedagogë-studentë. **[RVV fq.44; 32][Kapitulli I Standardi III.1]**

5.3 Secili fakultet po ngre një Zyrë Orientimi dhe Këshillimi, nën drejtimin e Zëvendës Dekanit dhe të paktën të dy pedagogëve të tjerë. **[138-140; FE28; M4]** Zyrat janë projektuar në mënyrë të tillë që t'iu ofrojnë studentëve aktualë dhe të ardhshëm informacionin dhe mbështetjen e nevojshme, duke përfshirë edhe dëshirën e tyre për të ndryshuar programin e studimit. **[RVV fq.43&45; 5; 133-136; 138; 139; FE28; M4]** Studentëve iu ofrohet një larmi informacionesh nëpërmjet fletëpalosjeve, shtypit dhe medias elektronike, faqes zyrtare të internetit, si edhe manualit të studentëve. **[RVV fq.45; 93; Faqja e internetit e universitetit; M4; M5]** Faqja e internetit ofron informacion të përgjithshëm për aplikantët, studentët dhe personelin, si për shembull për aktivitetet e ardhshme. Gjithashtu, universiteti është aktiv në rrjetet sociale, ofron intranet, si dhe çdo anëtar i personelit ka një llogari emaili të UST-së. **[RVV fq.45; Faqja e internetit e universitetit; M5]** Të dhënat personale të studentëve ruhen në sistemin e menaxhimit studentor nga Zyra e Regjistrimeve **[RVV fq.45; 5; 141; 144][Kapitulli I Standardi III.2, Kapitulli I Standardi III.3]**

5.4 Siç tregohet në pikën 3.2, universiteti ndjek një politikë për rritjen e diversitetit të studentëve të rinj. **[RVV fq.26; AE54; M3]** Studentët pohuan disponueshmërinë e programeve individuale dhe fleksible të studimit për studentët e shkëlqyer. **[RVV fq.46; 5; 71; 158; FE14; M3; M5]** Deri më sot, UST-ja ka rekrutuar një student me aftësi të kufizuara, dhe duke qenë në dijeni të faktit se Rektorati ka punuar me Ministrinë përkatëse me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në sporte të studentëve me aftësi të kufizuara, **[FE14; M3; M4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e një politike të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara si **dobësi**, dhe si rrjedhojë **rekomandon** që, universiteti të hartojë një politikë të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara. **[Kapitulli I Standardi III.4]**

5.5 Në bibliotekën e universitetit gjenden 3,581 libra, prej të cilëve 1,740 janë në gjuhë të huaja dhe 440 në gjuhën shqipe. Në pesë vitet e fundit janë shtuar afërsisht 200 tituj, si dhe është financuar përditësimi i fondit të bibliotekës. **[RVV fq.46-47; 93; 105; 106; M4]** Biblioteka shërben vetëm për referencë, ofron edhe materiale elektronike, dhe orari zyrtar përcaktohet në manualin e studentëve. **[93; turi për burimet e të nxëniet; faqja e internetit e universitetit]** Megjithëse në Anketimin e Studentëve, rreth 50 për qind e tyre raportuan se

nuk kanë gjithmonë akses te tekstet që ata dëshirojnë, ata shprehen se janë shumë të kënaqur me mbështetjen e ofruar nga biblioteka. **[Anketimi i Studentëve]**. Studentët që u takuan gjatë vlerësimit të jashtëm ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës dhe mendonin se ajo i plotësonte nevojat e tyre, por personeli pranoi nevojën për përmirësimin e aksesit në burimet online. **[M5; M8]** Zyra e Arkivit dhe Regjistrimit është përgjegjëse për regjistrimin, arkivimin, si dhe mbledhjen e dokumenteve dhe shkresave. **[SER p.46; 146]** Studentët kanë kartë regjistrimi. **[104][Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 Fakultetet udhëheqin dhe mentorojnë studentët gjatë përgatitjes së tezës së tyre dhe i ndihmojnë ata të gjejnë literaturën bazë dhe plotësuese. **[RVV fq.47; 5]** Për ta lehtësuar këtë gjë, monitorohen me kujdes nivelet e stafit akademik dhe në Anketimin e Studentëve, studentët raportojnë virtualisht se disponueshmëria e stafit akademik është e mjaftueshme. **[RVV fq.44; 032; Anketimi i Studentëve]** Studentët që u takuan gjatë vlerësimit të jashtëm u shprehën pozitivisht për gatishmërinë dhe mbështetjen e ofruar nga tutorët e tyre. **[M5]** Me propozim të Këshillit Studentor, është miratuar një protokoll i veçantë, që iu ofron studentëve akses në ambientet e palestrës pas orëve zyrtare të mësimdhënies. **[153][Kapitulli I Standardi III.6]**

5.7 Ka Këshilla Studentore në nivel institucional dhe fakulteti, që janë të pavarura, dhe që nxisin përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në organet drejtuese të universitetit. **[RVV fq.47; 5; 151; 152;147-150; 154-157; M3; M4]** Studentët që u takuan gjatë vlerësimit të jashtëm dhe që janë zgjedhur së fundmi në këshillin studentor të fakultetit të tyre ishin në gjendje ta përshkruanin mënyrën e funksionimit të Këshillave. **[M5]** Pavarësisht ofrimit të informacionit për punën e Këshillave Studentore në faqen e internetit dhe në këndin e njoftimeve elektronike, nga Anketimi i Studentëve doli se, ndërgjegjësimi i mekanizmave për angazhimin e studentëve në proceset universitare është i ulët. **[Anketimi i Studentëve; M3; M5]** Këshillat Studentore nuk mbështeten financiarisht, **[M3; M5; M7]** gjë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi**, dhe si rrjedhojë, **rekomandon** që universiteti të ofrojë mbështetje financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor. **[Kapitulli I Standardi III.7]**

5.8 Vizioni i UST-së është formimi i studentëve ambiciozë, të pavarur, me iniciativë dhe të mirëpërgatitur, dhe për këtë arsye universiteti ka marrë angazhimin strategjik të nxitjes së përfshirjes së tyre në veprimtari sportive ekstrakurrikulare. **[5]** Universiteti njihet historikisht për organizimin e veprimtarive sportive dhe për pjesëmarrjen në shumë veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare. **[M1; M6]** Siç theksohet në pikën 3.1, rregulloret e universitetit iu mundësojnë atletëve elitë, të identifikuar nga Ministria, të ndjekin programe studimi individuale, dhe studentëve që janë anëtarë të Klubeve Sportive të kategorisë së parë iu lejohet një qasje më fleksible kundrejt pjesëmarrjes. **[RVV fq.48; 5; 71; 158; M3; M5; M7]** Veprimtaritë dhe kampionatet sportive organizohen nga studentët, dhe atletët mbështeten për të konkurruar në aktivitete jashtë vendit. **[47; 48; 49; AE57; AE58; M4; M6]** Për të mbështetur shëndetin dhe mirëqenien e studentit, UST-ja punëson një mjek me kohë të plotë dhe një fizioterapeut. **[RVV fq.48; M4; M5][Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Në Planin Strategjik 2016-2020 shprehet qartë angazhimi për të mbështetur dhe ndihmuar studentët e të gjitha cikleve lidhur me punësimin, si dhe për praktikimin e mjaftueshëm të studentëve për zhvillimin e një larmie aftësish sportive. **[23; M3; M4; M5; M6]** Studentët u shprehën tejet të kënaqur me aftësitë e punësueshmërisë që fitojnë dhe me mbështetjen që marrin për t'u punësuar. **[Anketimi i Studentëve; M5]** Universiteti është në procesin e ngritjes së një Zyre Karriere në Zyrën e Marrëdhënies me Jashtë dhe Projekteve për ndjekjen e punësimit të studentëve. **[FE32; M4; M7]** Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, të dhënat për punësimin e të diplomuarve të mbajtura nga Zyra e Standardeve dhe Kurrikulës ishin të paplota. Universiteti i ka kërkuar Drejtorisë Arsimore informacion lidhur me të diplomuarit e punësuar nëpër shkolla, si edhe po kontakton me alumnit. **[RVV fq.48; RVV dok. 90; AE63; M7]** Sidoqoftë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e

konsideron mungesën e të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për punësimin e të diplomuarve si **dobësi**, dhe si rrjedhojë **rekomandon** që, universiteti të zhvillojë dhe zbatojë një proces për të mundësuar ngritjen e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse për ndjekjen e punësimit të të gjithë të diplomuarve të tij. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një politike të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- mungesën e mbështetjes financiare të Këshillave Studentore (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- mungesën e bazës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për punësimin e të diplomuarve (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- përgatitja e një politike të qartë për pranimin dhe mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- ofrimi i mbështetjes financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**)
- zhvillimi dhe zbatimi i një procesi për të mundësuar ngritjen e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse për ndjekjen e punësimit të të gjithë të diplomuarve të tij (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e referencave

Tabela 1

Të përfshira në faqet 52-55 të Raportit të Vetëvlerësimit dhe të përmendura gjatë gjithë raportit si dokumente të RVV-së me numrin përkatës (për shembull, 2).

1.	1. Ligji_80_2015_22_07_2015
2.	1.1.1 Rregullorja e UST-së
3.	1.1.2 Statuti i UST-së
4.	1.1.3.2 Vendimi i Senatit për ndryshimet në Rregulloren e UST-së
5.	1.2.1 Struktura e UST-së 2016-2017
6.	1.2.2 Vendimi nr. ____ datë _____ “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”
7.	1.2.2.1 Shpërndarja e transferimeve të pakushtëzuara
8.	1.2.3.1 Vendimi i Senatit për ndryshimet në Rregulloren e Brendshme të UST-së
9.	1.2.4.1 Për studentët që marrin gradën shkencore “Doktor”
10.	1.2.6.1 Vendimi për ngritjen e Këshillit të Etikës së UST-së
11.	1.2.6.2 Kodi i Etikës së UST-së
12.	1.3.1 Rregullorja e Këshillit të Profesorëve
13.	1.3.3.2 Marrëveshje dypalëshe
14.	1 1.3.3.2 Marrëveshje dypalëshe
15.	2 1.4.1.1 Vendimi i Brendshëm i Inspektimit për veprimtarinë akademike 2014-2015
16.	1.4.1.2 Vendimi i Brendshëm i Inspektimit për veprimtarinë akademike 2013-2015
17.	1.4.3.1 Projekte me përfshirjen e partnerëve
18.	1.5.1 Vendimi i planit strategjik
19.	1.5.2.1 Plani Strategjik i FSHL-së
20.	1.5.2.2 Plani Strategjik i FVFR-së
21.	1.5.2.3 Plani Vjetor dhe Plani Strategjik i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit
22.	1.5.3.1 Plani Vjetor i UST-së, 2016-2017
23.	1.5.3.2 Plani Vjetor i FSHL-së, 2016-2017
24.	1.5.3.3 Plani Vjetor i FVFR-së
25.	1.5.3.4 Plani Vjetor i drejtorive të UST-së
26.	1.6.1.1 Analiza Vjetore e UST-së, 2016
27.	1.7.3.1 Marrëveshje bashkëpunimi për praktikën pedagogjike
28.	1.7.3.2 Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit (Bashkia Tiranë)
29.	1.7.4.1 Pjesëmarrja në konferenca
30.	1.7.4.2 Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të UST-së
31.	1 1.7.4.2 Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve të UST-së
32.	1.7.4.3 Lektorë të ftuar
33.	1.7.5.1 Bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për ndjekjen e studentëve
34.	2.3.5 Përmirësimi i programeve për vendimin e Senatit
35.	2.4.1.4 Rregullore e FSHL-së për Studimet e Doktoraturës
36.	2.4.3.5 Dokument - Përvojë kërkimore ose akademike në universitetet e huaja
37.	3.1.1.1 Model fletëpalosjeje në panairin e universiteteve të organizuar nga MAS
38.	3.1.1.2 Model fletëpalosjeje i UST-së

39.	3.1.1.3 Model fletëpalosjeje i FSHL-së
40.	3.1.1.4 Model fletëpalosjeje i FVFR-së
41.	3.1.1.4.1 Konferencë për studentët
42.	3.1.1.4.2 Konferencë për personelin
43.	3.1.1.4.2 UST sport 1
44.	3.1.1.4.2 UST sport 2
45.	3.1.1.5.1 Bachelor në Shkencat e Lëvizjes në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes
46.	3.1.1.5.2 Master Profesional për Mësues të Edukimit Fizik në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes 3.1.1.5.3 Master Profesional në Trajnimin Sportiv në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes
47.	3.1.1.5.1 Master i Shkencave në Shkencat Sportive në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes
48.	3.1.1.5.5 Bachelor në Shkencat e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
49.	3.1.1.5.5 Master Profesional në Veprimtari Fizike dhe Rekreacion në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
50.	3.1.1.5.5 Master i Shkencave në Veprimtari Fizike dhe Shëndet në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
51.	3.1.1.5.8 Programi i syllabusit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes pjesa 1
52.	3.1.1.5.9 Programi i syllabusit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes pjesa 2
53.	3.1.1.5.10 Programi i syllabusit Master Profesional në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes
54.	3.1.1.5.11 Programi i syllabusit Master i Shkencave në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes
55.	3.1.1.5.12 Programi i syllabusit Bachelor në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit pjesa 1
56.	3.1.1.5.13 Programi i syllabusit Bachelor në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit pjesa 2
57.	3.1.1.5.14 Programi i syllabusit Master Profesional në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
58.	3.1.1.5.15 Programi i syllabusit Master i Shkencave në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
59.	3.1.1.6 Për informimin e studentëve që braktisin shkollën për vitin 2017 nga MAS-i
60.	3.1.2.1 Vendimi i Këshillit të Ministrave për Atletët Elitë
61.	3.1.3.1 Raport për Tregun e Punës
62.	3.1.3.1.1 Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 611, datë 31.12.2010
63.	3.1.3.1.2 Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 51, datë 05.02.2015
64.	3.1.4.1 Projekte me përfshirjen e universiteteve homologe
65.	3.1.5.1 Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008
66.	3.1.5.2 PAGESA për orët shtesë
67.	3.1.5.3 Marrëveshje Vjetore e Stafit Akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë
68.	3.1.7.1 Diplomë Bachelor në FSHL (me kohë të plotë)
69.	3.1.7.2 Supplement Bachelor në FSHL me kohë të plotë
70.	3.1.7.3 Praktika e transferimit të studimeve
71.	3.1.7.3. Praktika e transferimit të studimeve 1
72.	3.1.7.3. Praktika e transferimit të studimeve 2
73.	3.1.7.4 Poster për Menaxhimin Sportiv – program i detajuar

74.	3.1.7.5 Fletëpalosje SPEED
75.	3.1.7.6 Fletëpalosje SPEED Tempus për Transformimin e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sportit – në gjuhën shqipe
76.	3.1.8.5 Struktura e UST-së 2016-2017
77.	3.1.8.6 Struktura e pedagogëve me kohë të pjeshme 2016-2017
78.	3.1.9.1 Raporti i MAS-it për vitin 2016 për kapacitetet pritëse
79.	3.5.5.1 Bashkëpunim me MAS-in për ndjekjen e studentëve
80.	3.5.5.1.1 Ngritja e grupit për ndjekjen e studentëve
81.	3.5.5.1.1 Vendim i Senatit për ngritjen e strukturës së ndjekjes së studentëve
82.	3.6.6.1 Pedagogë me kohë të pjeshme
83.	3.10.2.1 Manual i UST-së për Studentët
84.	3.10.5.1 Udhëzim qartësues i MAS-it për Gjuhët e Huaja
85.	3.12.1.1. Licencë si Ciceronë për studentët e FVFR-së
86.	3.12.2.1 Model Programi për Praktikën Profesionale
87.	4.1.8.3 Program Transparence për informimin publik
88.	4.1.8.4 Mbrojtja e të dhënave personale
89.	4.2.1.1.1 Departamentet përgjegjëse për ciklet e studimit në FSHL
90.	4.2.1.1.2 Departamentet përgjegjëse për ciklet e studimit në FVFR
91.	4.2.1.3 Lidhja me infrastrukturën e UST-së
92.	4.2.1.3.1 Informacion për stafin akademik dhe personelin administrativ
93.	4.2.1.5 INFORMACION RASH
94.	4.2.1.5.1 Karta e studentit e UST-së
95.	4.2.1.5.2 Lista e librave mbi 5-vjeçarë
96.	4.2.1.5.3 Kontrata e librave e UST-së
97.	4.2.1.5.4 Fletëpalosje
98.	4.2.1.6 Pjesëmarrja e personelit të UST-së në aktiviteteve ndërkombëtare shkencore gjatë vitit 2016
99.	4.2.1.7.1 Model Kampioni 2 për Departamentin
100.	4.2.1.7.2 Shtojca 1
101.	4.2.1.7.3 Model Ndhmës Kampioni 1
102.	4.2.1.7.4 Puna Shkencore e Departamentit të Mjekësisë 2015-2016
103.	4.2.1.7.5 Formular Vlerësimi për Punën e Kërkimit Shkencor
104.	4.2.2.2 2016 Thirrje për Projekte Kërkimi
105.	4.2.2.3 Katalogu i UST-së për periudhën 2013-2017 për punimet e kërkimit shkencor
106.	4.2.2.10 Formular Vlerësimi për Infrastrukturën e Kërkimit – laboratorit i biomekanikës
107.	4.2.2.11 Formular Vlerësimi për Infrastrukturën e Kërkimit – laboratorit i fiziologjisë
108.	4.2.2.12 Formular Vlerësimi për Infrastrukturën e Kërkimit – laboratorit i biokimisë (1)
109.	4.2.2.13 Formular Vlerësimi për Bibliotekën ust.edu.al
110.	4.2.3.2 Analiza e pyetësorit të studentëve të UST-së, e kryer në shkurt të vitit 2017
111.	4.2.3.3 Grupi i punës për vlerësimin e cilësisë
112.	4.2.3.4 Përbërja e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë të FSHL-së
113.	4.2.3.5 Përbërja e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë të FVFR-së
114.	4.2.3.6 Raport inspektimi për grupin e punës së UST-së
115.	4.3.1.3 Konferenca Shkencore 2017
116.	4.3.1.6 Udhëzime për autorët e JPAS
117.	5.1.1.1 Normat e pranimit të vajzave dhe djemve në FVFR
118.	5.1.1.2 Normat e pranimit të vajzave në FSHL

119.	5.1.1.3	Normat e pranimit të djemve në FSHL
120.	5.1.1.4	Kartat e Shëndetit të Studentëve
121.	5.1.1.5	Vendim i Senatit nr. 6, datë 12.01.2017 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2017-2018
122.	5.1.1.6	Miratimi nga Senati i kriterëve të pranimit të UST-së
123.	5.1.1.7	Vendim i Senatit për ndryshimin e normave nga FSHL-ja
124.	5.1.1.8	Vendim i Rektoratit dhe Senatit për miratimin e kuotave të pranimit
125.	5.1.2.1	Orët e pritjes në zyrat e administratës
126.	5.1.2.2	Orët e pritjes së studentëve në FSHL
127.	5.1.2.3	Orët e pritjes në zyrën e këshillimit në FSHL
128.	5.1.2.4	Orët e pritjes në zyrën e këshillimit në FVFR
129.	5.1.2.4.1	Ndryshim në orët e pritjes në FVFR
130.	5.1.2.5	Përbërja e zyrës së këshillimit në FSHL
131.	5.1.2.6	Përbërja e zyrës së këshillimit në FVFR
132.	5.1.2.7	Vendim për ngritjen e Zyrave të Këshillimit në Fakultete
133.	5.1.3.1	Regjistri Bachelor i FVFR-së
134.	5.1.3.2	Regjistri i Masterit Profesional të FVFR-së
135.	5.1.3.3	Regjistri Masterit të Shkencës të FVFR-së
136.	5.3.2.2.1	Informacioni për regjistrin përmban të dhëna personale të studentëve
137.	5.3.5.1	Katalogu i librave të njësive bazë të UST-së
138.	5.3.5.2	Për një performancë të mirë arkivore
139.	5.7.1.0	Krijimi i Këshillit Studentor
140.	5.7.1.1	Këshilli Studentor i FSHL-së
141.	5.7.1.2	Vendim i FVFR-së për Këshillin Studentor
142.	5.7.1.3	Këshilli Studentor i FVFR-së
143.	5.8.1.4	Pedagog ndihmës për studentët e FSHL-së
144.	5.8.1.5	Pedagog ndihmës për studentët e FVFR-së
145.	5.8.2	Manual për përdorimin e ambienteve të palestrës së UST-së nga studentët
146.	5.8.2.1	Grupi i Punës për Statutin
147.	5.8.2.2	Grupi i Tretë i Punës së Fakultetit
148.	5.8.2.3	Grupi i Punës për Kodin e Etikës
149.	5.8.2.4	Grupi i Punës për Rregulloren e UST-së
150.	5.8.3.1	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1720, datë 29.10.2008 për studimet e atletëve elitë

Tabela 2

Dokumentacioni i kërkuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe i ofruar nga universiteti përpara vizitës së vlerësimit të jashtëm, referuar gjatë gjithë raportit si AE me numrin përkatës (për shembull, **AE 2**).

1.		Lista e referencave të dokumenteve shtesë.
2.	2.4.1	Struktura akademike në gjuhën shqipe
3.	2.4.2.2.1	Ftesë për pjesëmarrje në konferencë ndërkombëtare
4.	2.4.3.1	Ftesë për pjesëmarrje në konferencë ndërkombëtare
5.	2.4.3.2	Në gjuhën shqipe - raport i gjerë me numrin e studentëve - mundësisht i dobishëm
6.	2.4.3.3.	Ftesë për progres raporte në doktoraturë
7.	2.4.3.4	Në gjuhën shqipe - lista e profesorëve
8.	2.4.4.2	Në gjuhën shqipe - të dhënat e përshkrimit
9.	2.6.1.1	Në gjuhën shqipe

10.	2.6.1.3	Në gjuhën shqipe
11.	2.6.1.4	Në gjuhën shqipe
12.	2.6.2.3	Në gjuhën shqipe
13.	2.6.2.5	Në gjuhën shqipe
14.	2.7.1.2	Në gjuhën shqipe
15.	2.7.1.3.1	Broshura e universitetit
16.	2.7.2.1	Në gjuhën shqipe
17.	2.7.2.1.1	Në gjuhën shqipe
18.	2.7.2.2	Në gjuhën shqipe - numri i kompjuterave dhe laptopëve
19.	2.7.3.1	Në gjuhën shqipe
20.	2.7.4.3	Në gjuhën shqipe - broshura e bibliotekës
21.	2.7.6.2	Në gjuhën shqipe
22.	2.5.1.1	Në gjuhën shqipe
23.	2.5.1.2	Në gjuhën shqipe
24.	2.5.1.10	Në gjuhën shqipe
25.	2.5.1.12	Fotografi të gjeneratorëve
26.	2.5.2.1	Në gjuhën shqipe
27.	2.4.4.1	Në gjuhën shqipe
28.	3.1.1.6	Në gjuhën shqipe
29.	1.10	Letër për Ministrinë lidhur me raportin vjetor
30.	1.12	Kurrikulat e Shkencave Sportive të Raportit Tempus në Shqipëri
31.	1.3	Në gjuhën shqipe - procesverbal me shkrim dore për Mbledhjen e Rektoratit
32.	1.4	Në gjuhën shqipe - procesverbal me shkrim dore për Mbledhjen e Senatit
33.	1.9	Plani Strategjik 2016 -2020 (njësoj si në pikën 1.5.1)
34.	1.14	Marrëveshja ERASMUS për Mësimnxënien, Universiteti i Romës
35.	2.1	Broshurë (sërish!)
36.	2.3	Në gjuhën shqipe - lista e profesorëve (sërish!)
37.	2.4	Fotografi
38.	3.2	Prova kërcim së gjati nga vendi për pranim
39.	4.2.1	Libri i abstrakteve
40.	5.1	Në gjuhën shqipe
41.	5.2.1	Kryesisht në gjuhën shqipe = Lojërat Sportive Ballkanike 2016
42.	5.2	Në gjuhën shqipe - rreth basketbollit
43.	1.1	Procesverbali i mbledhjes së Rektoratit
44.	1.2	Procesverbali i mbledhjes së Senatit
45.	1.13.1	Kërkesë për zhvillimin e praktikës në shkolla (Përkthim i 3.12.2.1)
46.	1.13	Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë
47.	2.5	Të dhëna për punësueshmërinë (Përkthim i 3.1.3.1)
48.	3.2.1	Në gjuhën shqipe - miratimi i Senatit i referohet miratimit të kuotave të pranimit për studentët nga rajoni dhe nga territore si Kosova, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci, dhe Maqedonia.
49.	3.5	Suplementi i diplomës
50.	3.15	Letër nga MAS-i për provimin e gjuhës angleze (Përkthim i 3.10.5.1)
51.	4.2	Kërkesë financimi nga MAS-i për personelin për të marrë pjesë në konferencë ndërkombëtare
52.		TREGUES I KËRKESAVE PËR DOKUMENTE SHITESË
53.	1.1.2.5	Ekstrakti i Statutit

54.	2.4.1.2.1	Rekrutimi i pedagogëve të jashtëm
55.	3.12.1.1	Licencimi i ciceronëve (përkthim)
56.	2.5.2.1	Në gjuhën shqipe

Tabela 3

Dokumentacioni i kërkuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe i ofruar nga universiteti gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Referuar gjatë gjithë raportit si FE me numrin përkatës (për shembull, **FE 2**).

1.	3.1.1.5.8	Programi i syllabusit
2.	3.1.1.5.9	Programi i syllabusit
3.	3.1.1.5.10	Programi i syllabusit
4.	3.1.1.5.11	Programi i syllabusit
5.	3.1.1.5.12	Programi i syllabusit
6.	3.1.1.5.13	Programi i syllabusit
7.	3.1.1.5.14	Programi i syllabusit
8.	3.1.1.5.15	Programi i syllabusit
9.	3.1.5.2	Në gjuhën shqipe - pagesë shtesë për mësimdhënien
10.	5.1.1.1	Në gjuhën shqipe - Standardet e pranimit të djemve dhe vajzave
11.	5.1.1.2	Në gjuhën shqipe - Standardet e pranimit të vajzave
12.	5.1.1.3	Në gjuhën shqipe - Standardet e pranimit të djemve
13.	5.1.1.4	Raporti mjekoligjor i studentëve për pranim
14.		Sistemi i kuotave për pranim
15.		Personeli i doktoraturës
16.		Shembuj të objektivave arsimore
17.	3.1.1.5.1	Objektiva arsimore në gjuhën shqipe – orët e realizuara mësimore
18.	3.1.1.5.2	Objektiva arsimore në gjuhën shqipe – orët e realizuara mësimore
19.	3.1.1.5.3	Objektiva arsimore në gjuhën shqipe – orët e realizuara mësimore
20.		Ngarkesa vjetore për pedagogët
21.		Vendim i fakultetit për orientim dhe këshillim
22.		Objektivat arsimore të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes
23.	10.1	Certifikatë për Ciceronë
24.	10.2	Kërkesa për zhvillimin e praktikës (dublikatë)
25.	10	Kërkesa për zhvillimin e praktikës
26.		Në gjuhën shqipe - Dokumente shtesë janë pyetësorët e studentëve
27.		LISTË KONTROLLI ME DOKUMENTE SHITESË
28.		Në gjuhën shqipe - Vendim i Rektoratit për zyrën e këshillimit dhe orientimit 2016
29.		Orari i studentëve
30.		Në gjuhën shqipe
31.		Mobiliteti i studentëve ERASMUS+
32.		Vendim për ngritjen e një strukture për ndjekjen e punësimit të të diplomuarve

Tabela 3

Dokumente nga mbledhjet gjatë vizitës për vlerësimin e jashtëm

M1	Mbledhja 1
M2	Mbledhja 2

M3	Mbledhja 3
M4	Mbledhja 4
M5	Mbledhja 5
M6	Mbledhja 6
M7	Mbledhja 7
M8	Mbledhja 8
M9	Mbledhja 9
M10	Mbledhja 10